

DOKUMENT I PRAKTIKËS

**KARAKTERI DALLUES I MARKAVE
TREDIMENSIONALE (MARKAT
FORMË), TË CILAT PËRMBAJNË
ELEMENTE VERBALE DHE/OSE
FIGURATIVE KUR FORMA NUK
ËSHTË DALLUESE NË VETVETE**

**ENTI SHPETËROR PËR PRONËSI
INDUSRIALE
I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
SË VERIUT**

Shënim për Zyrën e Pronësisë Intelektuale:

Ky Dokument i Praktikës është përgatitur në përputhje me Komunikimet e Përbashkëta që rezultojnë nga Praktika e Përbashkët e Markave Tregtare e zhvilluar nga Rrjeti i Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian (EUIPN) dhe ka për qëllim të ofrojë udhëzime lidhur me karakterin dallues të markave tre-dimensionale (markat formë) që përmbajnë elemente verbale dhe/ose figurative kur vetë forma nuk është dalluese në vetvete. Pasi bëhen sipas specifikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ato do të japin një përmbledhje të standardeve të cilësisë së Entit Shtetëror të Pronësisë Industriale për aplikimet e marra në rrugë elektronike dhe me letër.

Ky Dokument mbi praktikën, i miratuar në nivel kombëtar, do të zbatohet nga data **01.11.2024**. Dokumenti publikohet publikisht, me qëllim rritjen e mëtejshme të transparencës, sigurisë ligjore dhe parashikueshmërisë në dobi të ekzaminuesve dhe përdoruesve.

INFORMACION

Kjo praktikë është në lidhje me dallueshmërinë e markave tredimensionale (markat formë) që përmbajnë elemente verbale dhe/ose figurative kur forma nuk është dalluese në vetvete, me qëllim të vendosjes së një pragu minimal për karakterin dallues të markave formë kur vetë forma nuk është dalluese.

Kjo Praktikë bëhet publike përmes këtij Dokumenti Praktikë për qëllimin e rritjes së mëtejshme të transparencës, sigurisë ligjore dhe parashikueshmërisë në dobi si të ekzaminuesve, ashtu dhe të përdoruesve.

Objekti i kësaj praktike është vlerësimi i karakterit dallues gjithëpërfshirës të markave formë që përbëhen nga forma jo dalluese e vetë mallrave, paketimit ose kontejnerëve, dhe elementet e tjera, mbi të cilat shtrihet markat formë, në kuadër të ekzaminimit në baza absolute.

Çështjet e mëposhtme janë jashtë objektivit të praktikës:

- vlerësimi i dallueshmërisë së formësformës;
- vlerësimi i dallueshmërisë së elementeve në vetvete;
- pasojat në bazat relative;
- karakteri dallues i fituar;
- format, ose karakteristikat e tjera, që rezultojnë nga natyra e vetë mallrave, të cilat janë të nevojshme për të marrë një rezultat teknik, ose që u japin mallrave një vlerë thelbësore (Neni 4(1)(e) EUTMD).

1 PRAKTIKA

Teksti i mëposhtëm përmbledh mesazhet kyçe dhe deklaratat kryesore të parimeve të praktikës. Teksti i plotë mund të gjendet në fund të kësaj praktike.

Për të përcaktuar nëse pragu i karakterit dallues është përmbushur, duhet të mbahen parasysh një numër elementesh dhe faktorësh që ndikojnë në karakterin dallues të shenjës në tërësi.

ELEMENTET VERBALE DHE FIGURATIVE

Si pikënisje, nëse një formë jo dalluese përmban një element që është dallues në vetvete, kjo do të mjaftojë për ta bërë shenjën në tërësi me karakter dallues. Madhësia dhe proporcioni i elementeve verbale/figurative, si edhe kontrasti i tyre me formën dhe pozicioni i tyre i vërtetë në të, të gjithë janë faktorë që mund të ndikojnë në perceptimin e shenjës kur vlerësohet karakteri dallues i saj.

Madhësia/proporcioni

<p style="text-align: center;">DALLUES</p> <div style="text-align: center;">  </div> <p style="text-align: center;">Klasa 9 Kartat e sigurta të memories digjitale</p>	<p style="text-align: center;">DALLUES</p> <div style="text-align: center;">  </div> <p style="text-align: center;">Klasa 14 Orë</p>
<p>Kur elementi verbal/figurativ është mjaft i madh për t'u identifikuar qartë si element dallues dhe ka ndikim të mjaftueshëm në përshtypjen e përgjithshme të prodhuar nga shenja, kjo e bën shenjën në tërësi me karakter dallues.</p>	<p>Duhet të merren parasysh edhe realitetet specifike të tregut. Konsumatorët e kanë zakon të identifikojnë elementet e vogla të mallrave të caktuara. Pavarësisht nga vogëlsia e tyre, elementet verbale mund të identifikohen si elemente dalluese në përfaqësimin e shenjës.</p>
<p>Kontrasti i ngjyrave</p>	
<p style="text-align: center;">DALLUES</p> <div style="text-align: center;">  </div> <p style="text-align: center;">Klasa 32 Uji i pijshëm në shishe</p>	<p style="text-align: center;">JO DALLUES</p> <div style="text-align: center;">  </div> <p style="text-align: center;">Klasa 28 Top për të luajtur</p>
<p>Përdorimi i ngjyrave me pak kontrast mund të jetë i mjaftueshëm për të lejuar që një element të identifikohet si i veçantë në përfaqësimin e shenjës dhe të rezultojë në një shenjë me karakter dallues. Vlerësimi i përgjithshëm do të varet nga dallueshmëria e një elementi të tillë.</p>	<p>Kur elementi nuk mund të identifikohet qartë si dallues në përfaqësimin e shenjës për shkak të mungesës së kontrastit, elementi nuk do të ketë ndikim në vlerësimin e karakterit dallues së shenjës, pasi konsumatori nuk do të jetë në gjendje të identifikojë menjëherë një element të tillë dhe të dallojë shenjën përfundimisht nga shenjat e tjera.</p>
<p>Pozicioni</p>	

DALLUES	JO DALLUES
	
Klasa 3 Artikuj kozmetikë	Klasa 3 Artikuj kozmetikë
<p>Në disa situata, elementet mund të perceptohen ndryshe nga konsumatori për shkak të pozicionit të tyre në mallra, duke ndryshuar kështu gjetjen e karakterit dallues.</p>	

NGJYRAT

Në vlerësimin e karakterit dallues të një ngjyre, duhet të merret parasysh interesi i përgjithshëm për të mos kufizuar në mënyrë të panevojshme disponueshmërinë e ngjyrave për tregtarët e tjerë që shesin mallra ose shërbime të të njëjtit lloji në lidhje me ato për të cilat kërkohet regjistrimi (shih Libertel dhe Heidelberger Bauchemie).

JO DALLUES	DALLUES
	
Klasa 9 Kartat e memories / Klasa 20 Karrige	Klasa 7 Hapës elektrikë të portës
<p>Tjeshit fakti i shtimit të një ngjyre të vetme në formën e një malli në mungesë të ndonjë elementi tjetër dallues, verbal ose figurativ, nuk do ta bëjë shenjën dalluese në thelb. Kombinimi i ngjyrave të karriges përcjell një mesazh ekskluzivisht dekorativ dhe nuk do të njihet si referencë për origjinën e saj tregtare.</p>	<p>Nuk mund të përjashtohet që një rregullim i veçantë i ngjyrave që është i pazakonshëm për mallrat përkatëse dhe krijon një përshtypje të përgjithshme të paharrueshme mund ta bëjë shenjën në tërësi me karakter dallues.</p>

KOMBINIMI I FAKTORËVE DHE ELEMENTEVE

Ekzistojnë sigurisht situata kur një markë formë përmban më shumë se një nga elementët e shqyrtuar më sipër. Për më tepër, mund të ketë raste kur më shumë se një nga faktorët e mësipërm janë të rëndësishëm për të përcaktuar ndikimin e elementeve në dallueshmërinë e shenjës. Në të gjitha situatat, dallueshmëria e shenjës do të varet nga përshtypja e përgjithshme e prodhuar nga kombinimi i këtyre faktorëve dhe elementeve.

DALLUES



Klasa 30 Çokollata

JO DALLUES



Klasa 25 Këpucë / Klasa 16 Paketim

Kombinimi i një forme jo dalluese me elemente që konsiderohen pa karakter dallues mund ta bëjë shenjën në tërësi me karakter dallues. Në këtë shembull, megjithëse elementet e fjalës janë përshkruese, rregullimi i tyre si një diell ose një lule rezulton dalluese në një përshtypje të përgjithshme.

Rregullimi i rastësishëm i trajtave gjeometrike të thjeshta në formën e mallit të klasës 16 ose të paketimit të zakonshëm të këpucëve të klasës 25 nuk prodhon një përshtypje të përgjithshme dalluese, pasi konsumatori nuk do ta perceptojë këtë kombinim të veçantë si një tregues të origjinës tregtare, por vetëm si një dekorim të mundshëm të paketimit.

SQ

Praktika

**KARAKTERI DALLUES I
MARKAVE TREDIMENSIONALE
(MARKAT FORMË), TË CILAT
PËRMBAJNË ELEMENTE
VERBALE DHE/OSE FIGURATIVE
KUR FORMA NUK ËSHTË
DALLUESE NË VETVETE**

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	1
1.1	Objekti i këtij dokumenti.....	1
1.2	Përkufizimi i markave formë	1
1.3	Fusha e praktikës.....	2
1.4	Standardet e përbashkëta të përfaqësimit të shenjës.....	2
2	EKZAMINIMI I MARKAVE FORMË: VLERËSIMI I KARKTERIT DALLUES	3
3	PARIMET E PRAKTIKËS	4
3.1	Elementet verbale dhe figurative	4
3.1.1	Madhësia/proporcioni	4
3.1.2	Kontrasti	9
3.1.3	Pozicioni	14
3.2	Ngjyrat	16
3.3	Kombinimet e faktorëve dhe elementeve	19
3.3.1	Kombinimi i ndryshimeve	20
3.3.2	Kombinimi i elementeve jo dalluese.....	21
3.3.3	Kombinimi i elementeve verbale/figurative dhe ngjyrave dalluese dhe jodalluese	24

1 Hyrje

1.1 Objekti i këtij dokumenti

Ky Dokument Praktike synon të vendosë një prag minimal për karakterin dallues të markave formë që përmbajnë elemente të tjera kur vetë forma është jo dalluese. Dokumenti synon të shërbejë si referencë për zyrat e Pronësisë Intelektuale, shoqatat e përdoruesve, aplikantët, mbajtësit e të drejtave, përfaqësuesit dhe personat e tjerë të interesuar.

Dokumenti do të bëhet gjerësisht i disponueshëm dhe do të jetë lehtësisht i aksesueshëm, duke ofruar një shpjegim gjithëpërfshirës të parimeve në të cilat bazohet praktika. Këto parime janë projektuar që të aplikohen përgjithësisht, dhe synojnë të mbulojnë shumicën e rasteve. Megjithëse dallueshmëria duhet të vlerësohet rast pas rasti, këto parime do të shërbejnë si udhëzime për zyrën atëherë kur vlerësohet dallueshmëria e markave formë që përmbajnë elemente të tjera kur vetë forma është jo dalluese. Nuk përjashtohet që një shenjë mund të refuzohet për arsye të ndryshme nga mungesa e karakterit dallues.

Shembujt e shtuar në këtë dokument synojnë të ilustrojnë parimet e praktikës. Këta shembuj duhen parë në lidhje me arsyetimin e tyre dhe bazuar në supozimet mbi të cilat mbështeten.

1.2 Përkufizimi i markave formë

Markat formë janë marka tregtare që përbëhen nga forma tredimensionale ose shtrihen mbi to, duke përfshirë kontejnerët, paketimin, vetë produktin ose pamjen e tyre.

Markat formë, si të gjitha markat tregtare, duhet të përbëhen nga një shenjë që mund të dallojë mallrat e një ndërmarrjeje nga ato të ndërmarrjeve të tjera dhe duhet të jenë të gjendje të prezantohen në regjistrin në një mënyrë që t'u mundësojë autoriteteve kompetente dhe publikut të përcaktojnë qartë dhe saktë se cili është objekti i mbrojtjes që i akordohet pronarit të tij (neni 3 EUTMD). Për këtë qëllim dhe për të siguruar besueshmëri juridike, si edhe administrimin solid të sistemit të regjistrimit të markave tregtare, duhet të sigurohet që shenja të përfaqësohet në një mënyrë të qartë, të saktë, të vetëpërmbajtur, lehtësisht të arritshme, të kuptueshme, të qëndrueshme dhe objektive (Parafrazimi 13 EUTMD).

Markat formë ndahen zakonisht në tri kategori:

- format që nuk kanë lidhje me vetë mallrat dhe shërbimet;
- format që përbëhen nga forma e vetë mallrave ose pjesëve të mallrave;
- format e paketimeve ose të kontejnerëve.

Format që nuk kanë lidhje me vetë mallrat ose shërbimet janë zakonisht të veçanta. Megjithatë, mund të jetë më e vështirë të arrihet në një konstatim lidhur me dallueshmërinë, në rast të formave që përbëhen nga forma e vetë mallrave, paketimeve ose kontejnerëve.

Së fundi, megjithëse Gjykata ka deklaruar në një numër rastesh se nuk është e përshtatshme të zbatohen kritere më të rrepta kur vlerësohet karakteri dallues i markave tredimensionale që përbëjnë formën e vetë mallrave (07/10/2004, C-136/02 P, Torches, BE:C:2004:592, § 32), karakteristikat e tyre të veçanta, domethënë aftësia e tyre për të marrë formën e vetë produktit ose paketimit të tij, çojnë, në të vërtetë, në çështje dallueshmërie që nuk i prekin llojet e tjera të markave, duke vështirësuar konstatimin e dallueshmërisë pasi këto marka nuk do të perceptohen nga publiku përkatës në të njëjtën mënyrë si një fjalë ose një markë figurative (neni 30 i jurisprudencës së cituar më lart).

Publiku përkatës nuk e ka zakon të bëjë supozime lidhur me origjinën e produkteve në bazë të formës së tyre ose formës së paketimit të tyre. Prandaj, në mungesë të ndonjë elementi grafik (përfshirë ngjyrat) ose verbal, forma përkatëse duhet të deviohet në mënyrë të konsiderueshme nga norma ose zakonet e sektorit ose, nga ana tjetër, elemente të tilla grafike ose verbale bëhen thelbësore për të siguruar karakterin dallues të një marke formë që përndryshe mund të mos jetë e regjistrueshme.

1.3 Fusha e praktikës

Fushëveprimi i praktikës është si më poshtë:

Vlerësimi i dallueshmërisë gjithëpërfshirëse të markave formë që përbëhen nga forma jo dalluese e vetë mallrave, paketimit ose kontejnerëve, dhe elementet e tjera, mbi të cilat shtrihet markat formë, në kuadër të ekzaminimit absolut të bazave.

Për qëllime të kësaj praktike, format e përfshira si shembuj konsiderohen të jenë jo dalluese në thelb.

Në kuadër të praktikës, shqyrtohen elementet e mëposhtme:

- elementet verbale dhe/ose figurative;
- ngjyra e vetme dhe kombinimi i ngjyrave;
- kombinimi i elementeve.

Çështjet e mëposhtme janë jashtë objektivit të projektit:

- vlerësimi i dallueshmërisë së formës;
- vlerësimi i dallueshmërisë së elementeve në vetvete;
- pasojat në baza relative;
- karakteri dallues i fituar;
- format, ose karakteristikat e tjera, që rezultojnë nga natyra e vetë mallrave, të cilat janë të nevojshme për të marrë një rezultat teknik, ose që u japin mallrave një vlerë thelbësore (Neni 4(1)(e) EUTMD).

1.4 Standardet e përbashkëta të përfaqësimit të shenjës

Neni 3(b) EUTMD vendos standarde të qarta për përfaqësimin e të gjitha shenjave, duke përcaktuar se ato do të jenë në gjendje të prezantohen në regjistër në një mënyrë që t'u mundësojë autoriteteve kompetente dhe publikut të përcaktojnë qartë dhe saktë se cili është objekti i mbrojtjes që i akordohet pronarit të tij. Pika 13 shton rëndësinë e kërkesës që shenja të jetë në gjendje të përfaqësohet në mënyrë **të qartë, të saktë, të vetëpërbajtur, lehtësisht të arritshme, të kuptueshme, të qëndrueshme dhe objektive**, formulimi i së cilës është riprodhuar në Nenin 3(1) EUTMIR.

Përfaqësimi i një marke (në vijim 'përfaqësimi') përcakton objektin e regjistrimit, ashtu siç thuhet në nenin 3(2) EUTMIR ⁽¹⁾. Megjithëse EUTMD nuk përmban një deklaratë të tillë të qartë, ajo mund të nxirret gjithashtu nga Neni 3(b) EUTMD.

Për këtë arsye, përfaqësimin i qartë dhe i saktë i formës, së bashku me të gjitha elementet, mbi të cilat ajo shtrihet, do të përcaktojë objektin e kërkesës për markën tregtare ⁽²⁾.

⁽¹⁾ Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2018/626, e datës 5 mars 2018.

⁽²⁾ Parimet në këtë praktikë ilustrohen në shembujt e standardizuar në format 8x8cm.

2 Ekzaminimi i Markave Formë: Vlerësimi i karakterit dallues

- **Funksioni i një marke tregtare:** që një markë tregtare të ketë karakter dallues, ajo duhet të jetë në gjendje të përmbushë funksionin e saj thelbësor, përkatësisht të garantojë identitetin e origjinës tregtare të mallrave dhe/ose shërbimeve për konsumatorin, duke i mundësuar, pa asnjë mundësi konfuzioni, që të dallojë mallrat ose shërbimet nga mallrat dhe shërbimet e tjera që kanë një origjinë tregtare tjetër ⁽³⁾.
- **Referenca në mallra:** karakteri dallues duhet të vlerësohet, së pari, duke iu referuar mallrave, për të cilat kërkohet regjistrimi dhe, së dyti, duke iu referuar perceptimit të publikut përkatës — konsumatorit ⁽⁴⁾.
- **Perceptimi i konsumatorit ⁽⁵⁾ dhe standardi i njëtrajtshëm ligjor:** perceptimi do të konsiderohet ai që ka konsumatorit mesatar, i cili është i informuar mirë, si edhe i matur dhe i kujdesshëm në mënyrë të arsyeshme. Megjithatë, siç u tha më lart, perceptimi i konsumatorit mesatar nuk është domosdoshmërisht i njëjtë në rast të markave formë, në krahasim me markat verbale ose figurative që përbëhen nga një shenjë që është e pavarur nga pamja e mallrave që ato shënojnë (12/02/2004, C-218/01, Perwoll, EU:C:2004:88). Në këtë drejtim, realitetet e tregut luajnë një rol gjatë këtij vlerësimi pasi ato ndikojnë në perceptimin e konsumatorëve të një shenje që përbëhet nga vetë produkti ose paketimi i tij.

Ekzaminimi i karakterit dallues të markave formë duhet të kryhet në hapat e mëposhtëm.

Hapi 1: identifikimi i elementeve të shenjës dhe vlerësimi i karakterit dallues gjithëpërfshirë të tyre.

Zyra do të identifikojë të gjitha **elementet**, mbi të cilat shtrihet marka formë, si edhe dallueshmërinë gjithëpërfshirëse të tyre, të cilat për qëllimin e këtij komunikimi janë:

- elementet verbale dhe figurative,
- ngjyrat (një ngjyrë e vetme dhe një kombinim ngjyrash) dhe,
- kombinimi i sa më sipër.

Nëse forma shtrihet mbi elementet verbale/figurative, identifikimi dhe vlerësimi i dallueshmërisë së tyre duhet të përfshijë konsiderimin e faktorëve të mëposhtëm:

- madhësia/proporcioni i elementeve në krahasim me formën;
- kontrasti i elementit me formën dhe;
- pozicioni i elementit në formë.

Nëse forma shtrihet mbi ngjyrën dhe kombinimet e ngjyrave, identifikimi dhe vlerësimi i dallueshmërisë së tyre duhet të përfshijë konsiderimin e rregullimit të veçantë të ngjyrave në formën specifike.

⁽³⁾ Shih C-39/97, Canon, neni 28 dhe T-79/00, LITE, neni 26.

⁽⁴⁾ Shih C - 53/01 P, Linde, neni 41, C-363/99, Postkantoor, neni 34, çështje të bashkuara C-468/01 P deri në C-472/01 P, Tabs (3D), neni 33.

⁽⁵⁾ 'Konsumatori', për qëllimin e kësaj praktike, i referohet si publikut në përgjithësi ashtu edhe profesionistëve.

Hapi 2: vlerësimi i dallueshmërisë së shenjës në tërësi.

Vlerësimi i dallueshmërisë duhet të bazohet në përshtypjen e përgjithshme të kombinimit të formës dhe elementeve, mbi të cilat ajo shtrihet, në lidhje me mallrat në fjalë, duke marrë parasysh perceptimin e konsumatorit që mund të ndikohet nga realitetet specifike të tregut.

3 Parimet e praktikës

Si pikënisje, nëse një formë jo dalluese përmban një element që është dallues në vetvete, kjo do të mjaftojë për ta bërë shenjën në tërësi me karakter dallues.

Shembuj:

DALLUES	
Shenja	Komentet
 <p>Klasa 33 Verë</p>	<p>Shenja përbëhet nga forma jo dalluese e një shisheje dhe një element figurativ dallues i identifikueshëm. Për këtë arsye, shenja është në tërësi me karakter dallues.</p>

3.1 Elementet verbale dhe figurative

Madhësia dhe proporcioni i elementeve verbale/figurative, si edhe kontrasti i tyre me formën dhe pozicioni i tyre i vërtetë në të, të gjithë janë faktorë që mund të ndikojnë në perceptimin e shenjës kur vlerësohet karakteri dallues i saj.

3.1.1 Madhësia/proporcioni

Madhësia dhe proporcioni i elementeve duhet të merren parasysh kur vlerësohet karakteri dallues i një marke formë. Vlerësimi bazohet para së gjithash në përfaqësimin e shenjës, ashtu siç është paraqitur nga aplikanti, pavarësisht nga madhësia e zakonshme e produktit. Elementi dallues duhet të jetë qartë i dukshëm në përfaqësimin e shenjës në mënyrë që shenja të konsiderohet në tërësinë e saj me karakter dallues. Nuk kërkohen proporcione specifike midis elementeve dhe formës.

- Si pasojë, kur elementi verbal/figurativ është mjaft i madh për t'u identifikuar qartë si element dallues dhe ka ndikim të mjaftueshëm në përshtypjen e përgjithshme të prodhuar nga shenja, kjo e bën shenjën në tërësi me karakter dallues.

Shembuj:

DALLUES

Shenja



Klasa 9 Kartat e sigurta të memories digjitale

Komentet

Pavarësisht nga fakti që këto karta memorie janë shumë të vogla, elementi verbal është i madh në proporcion me formën dhe mund të identifikohet qartë si një element dallues në përfaqësimin e shenjës, duke e bërë shenjën në tërësi me karakter dallues .

- Nëse elementi është i madh, por identifikohet si jo dallues, vetëm madhësia e tij, në proporcion me formën, nuk mjafton për ta bërë shenjën në tërësi me karakter dallues.

Shembuj:

JO DALLUES

Shenja



Klasa 3 Artikuj kozmetikë

Komentet

Në këta shembuj, shenjat në tërësi nuk kanë karakter dallues pavarësisht nga elementet verbale/figurative jodalluese të mëdha mbi forma jo dalluese. Njëra përmban informacion përshkruar rreth mallrave në fjalë, ndërsa tjetra përmban përfaqësimin e një forme të thjeshtë gjeometrike, e cila gjithashtu nuk është dalluese.



Klasa 16 Paketim / Klasa 25 Këpucë

Gjithashtu, duhet të merren parasysh edhe **realitetet specifike të tregut**. Konsumatorët e kanë zakon të identifikojnë elementet e vogla të mallrave të caktuara. Në këtë rast, elementet me madhësi relativisht të vogël mund të kenë akoma një ndikim të mjaftueshëm për ta bërë shenjën në tërësi me karakter dallues për atë kohë sa madhësia e tyre mundëson që ato të identifikohen qartë si dalluese.

Shembuj:

DALLUES

Shenja



Klasa 18 Mbajtësit e kartave të biznesit në formën e kutive për karta

Komentet

Treguesit e vegjël të origjinës përdoren zakonisht për mallra të tilla si mbajtësit e kartave të biznesit ose për orë. Për këtë arsye, pavarësisht nga madhësia e vogël e elementeve verbale në krahasim me format jo dalluese, shenja në tërësi ka karakter dallues, pasi elementet verbale mund të identifikohen si elemente dalluese në përfaqësimin e shenjës, duke e bërë shenjën në tërësi dalluese.



Klasa 14 Orë



Klasa 12 Kamionë

Në këtë segment specifik, treguesit e origjinës zakonisht janë relativisht të vegla në krahasim me mallrat. Madhësia e vogël e elementit verbal në krahasim me kamionin nuk e pengon që ai të identifikohet qartë si një element dallues në përfaqësimin e shenjës, duke ndikuar në këtë mënyrë në përshtypjen e tij të përgjithshme, pasi konsumatorët janë të mësuar me këtë praktikë.

- Kur elementi verbal/figurativ është aq i vogël saqë nuk identifikohet si element dallues, ai nuk ka ndikim të mjaftueshëm në përshtypjen e përgjithshme dhe për këtë arsye nuk do ta bëjë formën në tëresinë e saj dalluese.

Shembuj:

JO DALLUES

Shenja




Klasa 33 Verë

Komentet

Në këta shembuj, elementet verbale/figurative janë aq të vogla sa që nuk mund të identifikohen në përfaqësimin e shenjës dhe dallueshmëria e tyre nuk mund të përcaktohet.

Për këtë arsye, ato nuk kanë ndikim të mjaftueshëm në përshtypjen e përgjithshme dhe shenja nuk ka në tërësi karakter dallues.



3.1.2 Kontrasti

Përdorimi i kontrastit gjithashtu mund të ndikojë në kapacitetin e elementit(eve) verbale/figurative për t'u identifikuar dhe në fund të fundit për ta bërë shenjën në tërësi me karakter dallues. Kontrasti mund të arrihet duke përdorur nuanca të ndryshme të ngjyrave ose duke stampuar në relief/gdhendur/stampuar në basreliev elemente të caktuara në mallrat specifike.

a. Kontrasti i ngjyrave

- Përdorimi i ngjyrave me pak kontrast mund të jetë i mjaftueshëm për të lejuar që një element të identifikohet si i veçantë në përfaqësimin e shenjës dhe të rezultojë në një shenjë me karakter dallues. Vlerësimi i përgjithshëm do të varet nga dallueshmëria e një elementi të tillë.

Shembuj:

DALLUES	
Shenja	Komentet
 <p>Klasa 33 Verë</p>	<p>Pavarësisht nga përdorimi i ngjyrave me pak kontrast, elementi figurativ në shishe është ende në gjendje t'i japë shenjës në tërësi një karakter dallues, pasi elementi mund të identifikohet qartë si dallues në përfaqësimin e shenjës.</p>

- Në të kundërt, kur elementi nuk mund të identifikohet qartë si dallues në përfaqësimin e shenjës për shkak të mungesës së kontrastit, elementi nuk do të ketë ndikim në vlerësimin e karakteri dallues së shenjës, pasi konsumatori nuk do të jetë në gjendje të identifikojë menjëherë një element të tillë dhe të dallojë shenjën nga shenjat e tjera.

Shembuj:

JO DALLUES

Shenja



Klasa 28 Top për te luajtur

Komentet

Në këtë rast, elementi nuk mund të identifikohet qartë pa një inspektim të afërt, për shkak të mungesës së kontrastit midis elementit dhe sfondit të tij. Kombinimi i të dyja elementeve nuk e bën shenjën në teresi me karakter dallues ⁽⁶⁾.

b. Gdhendja/Stampimi në relief/Stampimi në basreliev

Gdhendja do të kuptohet në këtë kontekst si veprimi i prerjes ose gdhendjes (së një teksti ose dizajni) në sipërfaqen e një objekti të ngurtë.

Stampimi në relief do të kuptohet këtu si veprimi i gdhendjes, formësimit ose stampimit të një dizajni në (një sipërfaqe ose objekt) në mënyrë që të dallohet me relief të ngritur.

Stampimi në basreliev do të kuptohet këtu si veprimi i 'gdhendjes, formësimit ose stampimit të një dizajni në (një sipërfaqe ose objekt) në mënyrë që të dallohet me një relief të zbritur'.

Për shkak të natyrës së tyre, ngjyra e gdhendjeve/stampimeve në relief/stampimeve në basreliev përzihet me vetë produktin, duke vështirësuar perceptimin dhe identifikimin e tij. Megjithatë, gdhendjet përdoren shpesh për të dalluar markat formë.

⁽⁶⁾ Kontrasti mund të ndryshojë në varësi të kushteve të shikimit (ekrane, pamjet e shtypura etj.) duke e bërë elementin pak a shumë të identifikueshëm. Për qëllimet e kësaj praktike, do të konsiderohet që elementi nuk është qartësisht i identifikueshëm.

- Efekti i gdhendjes/stampimit në relief/stampimit në basreliev mund të ndikojë gjithashtu në identifikimin e elementit dhe vlerësimin e përgjithshëm të dallueshmërisë së shenjës. Kur një element do të identifikohet, mund të merret një vendim lidhur me dallueshmërinë e tij.

Shembuj:

DALLUES

Shenja



Klasa 32 Pije

Komentet

Elementi i stampuar mund të identifikohet si dallues në përfaqësimin e shenjës dhe për këtë arsye, shenja në tërësi ka karakter dallues.



Klasa 16 Kuti për lapsa

Elementi i gdhendur mund të identifikohet gjithashtu si dallues në përfaqësimin e shenjës së treguar dhe, për këtë arsye, shenja në tërësi ka karakter dallues.

JO DALLUES

Shenja

Komentet



Klasa 11 Aparat për thekjen e bukës

Elementi figurativ i gdhendur nuk ka një kontrast të mjaftueshëm me formën dhe prandaj nuk mund të identifikohet qartë në përfaqësimin e shenjës. Për këtë arsye, shenja nuk mund të konsiderohet në tërësi me karakter dallues.

- Në parim, ghdendja/stampimi në relief/stampimi në basreliev i një elementi jo dallues mbi një formë jo dalluese nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të karakterizuar shenjën si dalluese.

Shembull:

JO DALLUES

Shenja

Komentet



Klasa 32 Uji i pijshëm në shishe

Ky element jo dallues (një formë gjeometrike e thjeshtë — rreth), i cili është gdhendur mbi një formë jo dalluese, nuk e bën shenjën në tërësi me karakter dallues. Përshtypja e përgjithshme nuk ka karakter dallues, duke marrë parasysh se konsumatori nuk do të ketë mundësi të dallojë këtë mall si një mall që vjen nga një ndërmarrje specifike.

JO DALLUES

Shenja



Klasa 32 Uji i pijshëm në shishe

Komentet

Këto elemente jo dalluese, të cilat janë gdhendur mbi një formë jo dalluese, nuk e bëjnë shenjën në tërësi me karakter dallues. Përshtypja e përgjithshme nuk është dalluese, duke marrë parasysh se konsumatori nuk do të jetë në mundësi të dallojë këtë mall si një mall që vjen nga një ndërmarrje specifike.

3.1.3 Pozicioni

Pozicioni i një elementi, mbi të cilin shtrihet shenja është gjithashtu një faktor që duhet të merret parasysh kur vlerësohet karakteri dallues i shenjës, pasi do të ndikojë në kapacitetin e një elementi të tillë për t'u identifikuar si dallues apo jo, dhe në fund të fundit për t'i dhënë një karakter dallues shenjës.

- Në përgjithësi, elementet dalluese do ta bëjnë shenjën në tërësi me karakter dallues, pavarësisht nga pozicioni i tyre në mall dhe nga prezantimi i zakonshëm i produktit në treg, për aq kohë sa ato mund të identifikohen si dalluese në përfaqësimin e kërkesës për një markë tregtare.

Shembuj:

DALLUES	
Shenja	Komentet
 <p>Klasa 32 Uji i pijshëm në shishe</p>	<p>Elementet verbale dhe figurative mund të identifikohen si dalluese në të gjithë shembujt, pavarësisht nga pozicioni i tyre dhe prandaj ato bëjnë të gjitha shenjat në tërësi me karakter dallues.</p> <p>Megjithëse treguesit e origjinës tregtare nuk vendosen zakonisht në pjesën e poshtme të shishes, ashtu siç tregohet në shembullin e fundit, kjo mundësi nuk mund të përjashtohet.</p>
 <p>Klasa 32 Uji i pijshëm në shishe</p>	<p>Treguesit e origjinës zakonisht mund të gjenden në shollën e këpucëve. Në këtë rast, elementi dallues është vendosur në një pozicion të</p>

DALLUES

Shenja



Klasa 25 Këpucë

Komentet

prishëm dhe mund të identifikohet qartë si dallues në përfaqësimin e shenjës dhe për këtë arsye ai mund ta bëjë shenjën në tërësi me karakter dallues.

JO DALLUES

Shenja



Klasa 33 Verë

Komentet

Etiketa që përmban elementin përshkrues verbal, e vendosur në një pozicion tipik për këtë lloj paketimi mallrash, nuk e bën shenjën në tërësi me karakter dallues.



Klasa 33 Verë

Elementi jo dallues (ndoshta viti i prodhimit) e vendosur në pjesën e poshtme të shishes që mund të mos jetë pozicioni tipik për këtë lloj informacioni përshkrues. Megjithatë, pozicioni i pazakonshëm nuk e shton karakterin dallues të elementit qartësisht jo dallues dhe prandaj shenja nuk është në tërësi me karakter dallues.

- Në disa situata, elementet mund të perceptohen ndryshe nga konsumatori për shkak të pozicionit të tyre në mallra, duke ndryshuar kështu gjetjen e dallueshmërisë.

Shembuj

DALLUES	JO DALLUES	Komentet
 <p data-bbox="240 987 416 1043">Klasa 3 Artikuj kozmetikë</p>	 <p data-bbox="544 987 719 1043">Klasa 3 Artikuj kozmetikë</p>	<p data-bbox="799 427 1350 483">Elementi verbal 'CLOSE' nuk ka lidhje me mallrat në Klasën 3.</p> <p data-bbox="799 517 1350 663">Nëse vendoset në mes të produktit, elementi verbal perceptohet si dallues, pasi ai nuk tregon një element përshkrues të mallit. Për këtë arsye, shenja në tërësi ka karakter dallues.</p> <p data-bbox="799 696 1350 819">Sidoqoftë, nëse vendoset në pjesën e sipërme të produktit, pranë kapakut, ajo do të perceptohet si një tregues që përshkruan funksionin e hapjes/mbylljes së kapakut.</p>

3.2 Ngjyrat

Në vlerësimin e karakterit dallues të një ngjyre, duhet të merret parasysh interesi i përgjithshëm për të mos kufizuar në mënyrë të panevojshme disponueshmërinë e ngjyrave për tregtarët e tjerë që shesin mallra ose shërbime të të njëjtit lloji si ato për të cilat kërkohet regjistrimi, shih gjykimet e 06/05/2003, Libertel, C-104/01, EU:C:2003:244, neni 60, dhe të 24/06/2004, Blau/Gelb, C-49/02, EU:C:2004:384, neni 41.



Situatat në të cilat ngjyrat nuk mund të sigurojnë dallueshmëri për mallrat mund të jenë si më poshtë:

- në shumë raste, ngjyra është thjeshtësisht një element dekorativ i mallrave ose përputhet me kërkesat e konsumatorit (p.sh. ngjyrat e makinave ose bluzave), pavarësisht nga numri i ngjyrave në fjalë;
- ngjyra mund të përbëjë natyrën e mallrave (p.sh. bojërat);
- ngjyra mund të jetë teknikisht funksionale (p.sh. ngjyra e kuqe për fikësit e zjarrit, ngjyrat e ndryshme të përdorura për kabllot elektrike);
- ngjyrë mund të jetë gjithashtu **e zakonshme** (p.sh. ngjyra e kuqe për fikësit e zjarrit);
- ngjyra mund të tregojë një karakteristikë të veçantë të mallrave, të tilla si një aromë (ngjyra e verdhë për shijen e limonit ose ngjyra rozë për shijen e luleshtrydheve). Shih aktgjykimin e datës 03.05.2017, T-36/16, *SHIRITAT E GJELBËR NË NJË KUNJ (kol.)*, EU:T: 2017:295, nenet 43 deri 47, në të cilin Gjykata ka vendosur se ngjyra e gjelbër, e perceptuar si ngjyra e natyrës, do të çojë publikun përkatës ta kuptojë si një referim ndaj natyrës ekologjike të mallrave në fjalë (konvertuesit e energjisë së erës).

Ashtu siç konfirmohet nga Gjykata e Drejtësisë, konsumatorët nuk e kanë zakon të bëjnë supozime për origjinën e mallrave në bazë të ngjyrës së tyre ose ngjyrës së paketimit të tyre në mungesë të ndonjë elementi grafik ose verbal, sepse si rregull, ngjyra nuk përdoret si mjet identifikimi në praktikën tregtare të tanishme (06/05/2002, C-104/01, Libertel, EU:C:2003:244). Normalisht ngjyra nuk ka aftësinë e qenësishme për të dalluar mallrat e një ndërmarrjeje të veçantë (neni 65). Për këtë arsye, ngjyra e vetme në parim nuk është jetë dalluese për asnjë mall ose shërbim përveç në rrethana të jashtëzakonshme. Në çdo rast, ekzaminimi do të kërkojë një analizë rast pas rasti.

- Në parim, thjeshtë fakti i shtimit të një ngjyre të vetme në formën e një malli në mungesë të ndonjë elementi tjetër dallues, verbal ose figurativ, nuk do ta bëjë shenjën në thelb me karakter dallues.

Shembuj:

JO DALLUES	
Shenja	Komentet
 <p>Klasa 9 Karta e memories</p>	<p>Në këtë shembull, konsumatorët nuk do ta perceptojnë shtimin e ngjyrës së verdhë të vetme në formë si një tregues origjine. Përdorimi i ngjyrës në këtë lloj mallrash është i zakonshëm në treg.</p>
 <p>Klasa 16 Laps</p>	<p>Përdorimi i një ngjyre të vetme në këtë rast nuk do të perceptohet si një tregues origjine, por do të ofrojë informacion mbi natyrën e mallrave në fjalë. Prandaj, shenja nuk ka karakter dallues.</p>

- Megjithatë, nuk mund të përjashtohet që një rregullim i veçantë i ngjyrave që është i pazakonshëm për mallrat përkatëse dhe krijon një përshtypje të përgjithshme të paharrueshme mund ta bëjë shenjën në tërësi me karakter dallues.

Shembuj:

DALLUES

Shenja



Klasa 7 Turbinë për erë

Komentet

Ky rregullim i veçantë i ngjyrave në turbinën e erës është i pazakonshëm në treg dhe prandaj mund të krijojë mjaftueshëm një përshtypje të përgjithshme të paharrueshme për konsumatorin e specializuar, i cili do ta mbajë mend si një tregues identifikues.



Klasa 7 Hapës elektrike të derës

Ky rregullim i veçantë i ngjyrave në një motor tubular për portën e garazhit krijon një përshtypje të përgjithshme që mbahet mend lehtë. Në këtë treg specifik, mallrat kërkohen pothuajse ekskluzivisht nga konsumatorë profesionistë që janë të mësuar të identifikojnë origjinën tregtare të këtyre mallrave sipas ngjyrave. Mallrat nuk janë të dukshme rregullisht gjatë përdorimit dhe prandaj, kombinimi i ngjyrave nuk perceptohet si dekorativ.

Si rezultat, shenja në tërësi ka karakter dallues.

Shembuj:

JO DALLUES

Shenja



Klasa 9 Kasa për telefona celulare

Komentet

Në rasat të kasave për telefona celulare, përdorimi i kombinimeve të ngjyrave është i zakonshëm në treg. Prandaj, konsumatori nuk do ta perceptojë këtë kombinim ngjyrash si një tregues origjine, por si një dekorim të thjeshtë për këto mallra. Shenja në tërësi nuk ka karakter dallues.



Klasa 20 Karrige

Ky kombinim përcjell një mesazh ekskluzivisht dekorativ, i cili nuk do të identifikohet si referencë për origjinën e tyre. Për këtë arsye, shenja në tërësi nuk mund të konsiderohet me karakter dallues.

3.3 Kombinimet e faktorëve dhe elementeve

Ekzistojnë sigurisht situata kur një markë formë përmban më shumë se një nga elementët e shqyrtuar më sipër.

Për më tepër, mund të ketë raste kur më shumë se një nga faktorët e mësipërm janë të rëndësishëm për të përcaktuar ndikimin e elementeve në dallueshmërinë e shenjes.

Në të gjitha situatat, dallueshmëria e shenjes do të varet nga përshtypja e përgjithshme e prodhuar nga kombinimi i këtyre faktorëve dhe elementeve.

3.3.1 Kombinimi i ndryshimeve

- Kur disa faktorë (të tillë si madhësia, pozicioni ose kontrasti) ndikojnë negativisht në element, duke penguar identifikimin e tij si dallues, kjo do të çojë në një përshtypje të përgjithshme jo dalluese të shenjës.

Shembuj:

JO DALLUES

Shenja



Klasa 33 Verë

Komentet

Madhësia, pozicioni dhe mungesa e ngjyrave kontrastuese në elementin verbal rezultojnë në një përshtypje të përgjithshme jo dalluese. Elementi nuk mund të identifikohet si dallues në mall pa një inspektim shumë të afërt, pasi është vendosur në një vend më pak të dukshëm në shishe, duke përdorur një madhësi shumë të vogël dhe një kontrast të dobët. Për këtë arsye, shenja në tërësi nuk mund të konsiderohet me karakter dallues.



Klasa 9 Syze

Madhësia dhe gdhendja e elementit nuk mundësojnë që ai të jetë i identifikueshëm, pasi elementët nuk mund të gjenden pa një inspektim të afërt. Kjo rezulton në një përshtypje të përgjithshme jo dalluese.

DALLUES

Shenja



Klasa 9 Syze

Komentet

Në këtë rast, madhësia e elementit dhe kontrasti i tij me mallrat mundësojnë që ai të identifikohet si dallues: kjo rezulton krejtësisht në një përshtypje të përgjithshme dalluese.

3.3.2 Kombinimi i elementeve jo dalluese

- Në përgjithësi, kombinimi i një forme jo dalluese me elemente verbale dhe/ose figurative, të cilat konsiderohen individualisht si elemente pa karakter dallues, nuk rezulton në një shenjë dalluese.

Shembuj:

JO DALLUES	
Shenja	Komentet
 <p>Klasa 33 Verë</p>	<p>Elementet verbale dhe figurative nuk janë dalluese pasi ato ofrojnë informacion përshkrues të mallrave në fjalë. Megjithëse ato janë të vendosura në një pozicion qendror dhe pavarësisht nga madhësia e tyre e konsiderueshme dhe kontrasti i tyre i mjaftueshëm, ato nuk mund ta bëjnë shenjën në tërësi me karakter dallues pasi konsumatori nuk do ta perceptojë kombinimin si një burim origjine.</p>
 <p>Klasa 25 Këpucë / Klasa 16 Paketim</p>	<p>Rregullimi i rastësishëm i trajtave gjeometrike të thjeshta në formën e mallit të klasës 16 ose të paketimit të zakonshëm të këpucëve të klasës 25 nuk prodhon një përshtypje të përgjithshme dalluese, pasi konsumatori nuk do ta perceptojë këtë kombinim të veçantë si një tregues të origjinës tregtare, por vetëm si një dekorim të mundshëm të paketimit.</p>

JO DALLUES

Shenja

Komentet



Klasa 30 Drithëra

Kombinimi i elementeve jo dalluese nuk mund të sigurojë asnjë karakter dallues për shenjën, në rast se forma përbëhet nga një kuti jo dalluese drithërash, ashtu siç tregohet. Konsumatorët do ta perceptojnë si një formë bazë e zakonshme, duke përfshirë informacion përshkrues rreth mallrave në fjalë.



Klasa 30 Çokollatë

Ky kombinim elementesh, të cilat janë të gjitha jo dalluese në vetvete, nuk e bën shenjën në tërësi me karakter dallues.

- Megjithatë, kombinimi i një forme jo dalluese me elemente që konsiderohen individualisht si elemente pa karakter dallues mund të perceptohet si një tregues i origjinës tregtare për shkak të perceptimit të konsumatorit përkatës dhe përbërjes së shenjës, kur ato konsiderohen në tërësi.

Shembuj:

DALLUES	
Shenja	Komentet
 <p>Klasa 30 Çokollatë</p>	<p>Elementet përshkruese janë sistemuar në mënyrë që të krijojnë një formë dielli ose luleje; një kombinim që mund të perceptohet si një tregues i origjinës dhe që, për këtë arsye, e bën shenjën në tërësi me karakter dallues</p>
 <p>Klasa 33 Verë</p>	<p>Pikat e shumta të përsëritura, me një ngjyrë kontrastuese, të shtuara në formë jo dalluese rezultojnë në një kombinim të pazakonshëm në treg, duke e bërë shenjën në tërësi me karakter dallues.</p>
JO DALLUES	
Shenja	Komentet

JO DALLUES

Shenja



Klasa 21 Filxhanë për kafe

Komentet

Pikat e shumta të përsëritura, me një ngjyrë kontrastuese, do të shihen në këtë rast si një zbukurim i thjeshtë. Prandaj, elementet nuk mund ta bëjnë shenjën në tërësi me karakter dallues, sepse përdorimi i elementeve dekorative është i zakonshëm në tregun e mallrave në fjalë.

3.3.3 Kombinimi i elementeve verbale/figurative dhe ngjyrave dalluese dhe jo dalluese

- Në përgjithësi, kombinimi i një elementi dallues me elemente të tjera jo dalluese në një formë jo dalluese mund ta bëjë shenjën në tërësi me karakter dallues, për aq kohë sa elementi dallues mund të identifikohet qartë ndër të gjithë elementët e tjerë.

Shembull:

DALLUES

Shenja



Klasa 30 Çokollatë

Komentet

Pavarësisht nga kombinimi i shumë elementeve jo dalluese, elementi verbal 'ECS' mund të identifikohet si element dallues në përfaqësimin e shenjës për shkak të madhësisë, pozicionit dhe kontrastit të tij lidhur me mallin dhe për këtë arsye ai mund ta bëjë shenjën dalluese në tërësi.

- Megjithatë, nëse elementi dallues nuk perceptohet menjëherë nga konsumatori për shkak të pranisë së elementeve jo dalluese, kombinimi mund të rezultojë në një shenjë jo dalluese.

JO DALLUES

Shenja



Klasa 30 Çokollatë

Komentet

Elementi verbal ECS humbet ndër elementet e shumta jo dalluese. Për shkak të pozicionit, madhësisë dhe mungesës së kontrastit, ai nuk mund të identifikohet si element dallues pa inspektim të afërt dhe për këtë arsye, nuk mund ta bëjë shenjën në tërësi me karakter dallues.